

PËRMBAJTJA

- Çështje të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Kohëzgjatja e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
 - ✍ Çështje të korrupsionit
 - ✍ Çështje të krimin të organizuar
- Çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
 - ✍ Veprat penale
 - ✍ Masat e dënimit: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë
- Çështjet penale në fushën e krimin të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Çështje të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Spak Monitor Nr. 11 trajton ecurinë e çështjeve në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar të regjistruara në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke kryer një vlerësim përkundrejt disa indikatorëve të rëndësishëm në procesin e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve.

Nëpërmjet kësaj analize dhe paraqitjes të aspekteve kryesore që lidhen me shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve, synohet të evidentohet niveli i efektivitetit dhe përgjigjes në trajtimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ky botim vjen si një vazhdim i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm që Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes ka kryer në kuadër të projektit: “Mbështetja e zbatimit të reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme”, i mbështetur nga Programi i Reformës në Drejtësi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Grupi i punës së projektit falenderon Kancelarin dhe stafin mbështetës të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për mbështetjen e ofruar në marrjen e informacionit dhe të dhënave, të cilat kanë shërbyer për të realizuar një vlerësim sa më të plotë dhe të saktë për periudhën janar 2021 - mars 2021.



Çështje të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Janar-Mars 2021)


Gjatë periudhës janar – mars 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar në total **29 çështje të reja penale**, 18 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 6 në fushën e krimit të organizuar dhe 5 çështje të tjera të cilat përfshijnë vepra të tjera penale.

Muaji **janar 2021** rezulton të jetë muaji me numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara me 13 të tilla, ndërkohë që në muajin shkurt 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar 9 çështje penale dhe 7 çështje të tjera të regjistruara i përkasin muajit mars 2021.

Gjatë periudhës janar-mars 2021 kjo gjykatë ka dhënë në total **27 vendime, 8 vendime** për çështje penale të regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021 dhe **19 vendime**, të cilat i përkasin çështjeve penale të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020.

Në asnjë nga **8 vendimet** për çështjet e regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021, nuk përfshihen çështje në fushën e krimit të organizuar. Specifikisht 5 prej tyre janë çështje në fushën e korrupsionit, ndërkohë që 3 prej tyre përfshijnë vepra të tjera penale. Në **18 vendimet** për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2020, përfshihen 11 vendime për çështjeve në fushën e korrupsionit, 5 të krimit të organizuar dhe 2 prej tyre përfshijnë vepra të tjera penale.

Deri në fund të muajit mars 2021, nga 29 çështje në total ka vazhduar gjykimi për **21 prej tyre**, 13 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 6 në fushën e krimit të organizuar dhe 2 prej tyre të lidhura me vepra të tjera penale.



Grafik 1: Numri dhe ecuria e gjyimit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



Kohëzgjatja e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Janar-Mars 2021)

Çështje të korrupsionit

Për të llogaritur kohëzgjatjen e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, janë përfshirë data e regjistrimit të çështjes në gjykatë dhe data e shpalljes së vendimit. Intervali kohor i përdorur për vlerësimin e çështjeve përfshin segmentet kohore: **më pak se 1 muaj, 1-6 muaj, 7-12 muaj, 1-2 vjet dhe më shumë se 2 vjet.**

Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile në Nenin 399/2/d, afati i arsyeshëm i gjykimit të krimeve në gjykimin penal në shkallë të parë është **deri në 2 vjet** ndërsa përfundimi i gjykimit për krimet në gjykimin në apel është **1 vit.**

Nga vlerësimi i realizuar për 8 çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në këtë gjykatë gjatë periudhës kohore janar-mars 2021, evidentohet që për 4 prej tyre gjykimi ka përfunduar për një periudhë kohore më **pak se 1 muaj** dhe për 4 të tjera gjykimi ka përfunduar për një periudhë kohore prej më **pak se 2 muajsh**, duke mos tejkaluar as kohëzgjatjen mesatare të çështjeve në këtë gjykatë për vitin 2021, prej **135 ditësh.**

Nr. dhe lloji i Çështjes	Kohëzgjatja e çështjes				
	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet
Nr. 1 - Korrupsion		43 ditë			
Nr. 3 - Korrupsion	27 ditë				
Nr. 4 – Të tjera	25 ditë				
Nr. 5 – Të tjera		37 ditë			
Nr. 7 - Korrupsion		50 ditë			
Nr. 12 - Korrupsion		35 ditë			
Nr. 13 – Korrupsion	29 ditë				
Nr. 22 – Të tjera	14 ditë				

Tabela 1: Kohëzgjatja e gjykimit (në ditë) për çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



Çështje të krimit të organizuar

Deri në 31 mars 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë nuk ka përfunduar gjykimi për asnjë nga 6 çështjet penale të regjistruara në këtë gjykatë gjatë periudhës janar-mars 2021.

Çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Janar-Mars 2021)


Veprat penale

Çështjet penale në fushën e korrupsionit përbëjnë numrin më të lartë të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës kohore janar-mars 2021, prej **18 çështjesh** nga 29 në total.

Ashtu sikurse edhe për çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020, edhe në rastin e çështjeve të korrupsionit të regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021, dominojnë akuzat penale të korrupsionit ndaj **personave që ushtrojnë funksione publike**.

Specifikisht, veprat penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike përbëjnë akuzat kryesore të këtyre çështjeve për 3-mujorin e parë të vitit 2021.

Vetëm **1 çështje** penale në fushën e korrupsionit përfshin akuzën e korrupsionit aktiv të anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja dhe në **4 çështje** të tjera penale përfshihet akuzat e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.



Grafik 2: Numri i veprave penale në çështjet e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Asnjë çështje penale në fushën e korrupsionit e regjistruar gjatë kësaj periudhe nuk përfshin akuzat për korrupsion kundrejt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë.

Ndryshimet ligjore të miratuara nga Parlamenti i Shqipërisë, të cilat parashikojnë limitin e vlerave monetare për kryerjen e akteve korruptive kanë hyrë në fuqi në datën 23 mars 2021.



Çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar* (Janar-Mars 2021)

Masat e dënimit: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

Numri i më i lartë i të pandehurve / akuzuarve në çështjet penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës janar-mars 2021 është **19** dhe përfshin vepra penale në fushën e korrupsionit. Për 17 çështjet e tjera të korrupsionit, numri i të pandehurve është: 1 në 9 prej çështjeve, 2 në 5 çështje dhe 3 në 2 çështje.

Në asnjë nga **5 vendimet për 6 të pandehur**, të cilat janë dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për çështje penale në fushën e korrupsionit të regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021, nuk janë dhënë dënime me burgim. (Shiko Aneks A)

Ashtu sikurse në rastin e çështjeve të korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020, masat e ekzekutimit të dënimit me burgim janë zëvendësuar me **periudhë vënie në provë**. Vendosja e kontakteve me shërbimet e provës dhe vënia në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, mund të vendoset nga gjykata duke marrë në konsideratë disa kushte të caktuara.

Këto kushte përfshijnë rrezikshmërinë e paktë të personit,

Masa e dënimit të pezulluar

4 muaj
6 muaj
3 vjet/4 muaj
2 vjet
4 muaj
4 muaj

Periudha e vënies në provë

60 orë/6 muaj
12 muaj
5 vjet
4 vjet
8 muaj
8 muaj

Figura 1: Masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale të korrupsionit në rastet e Pezullimit të vendimeve të dënimit

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

moshën, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyrën së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së kësaj vepre. Ndërkohë detyrimet, të cilat i dënuari detyrohet të plotësojë nga gjykata parashikohen në nënin 60 të Kodit

Penal.

Provat materiale të sekuestruara dhe konfiskuara nga gjykata të të pandehurve të dënuar për korrupsion përfshijnë kryesisht vlera të vogla, të cilat variojnë nga 10 deri në 50 Euro. Shuma totale e këtyre provave arrin shumën prej **360,000 Lekë dhe 630 Euro**.

Çështjet penale në fushën e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Janar-Mars 2021)

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës janar-mars 2021, **6 çështje penale** në fushën e krimit të organizuar, për asnjërën prej të cilave deri në datën 31 mars 2021 nuk ka përfunduar gjykimi.

Veprat në **fushën e narkotikëve** dhe ato në **kuadër të organizatës kriminale** përbëjnë numrin kryesor të akuzave në çështjet penale në fushën e krimit të organizuar, ndërkohë që numri i të pandehurve në këto çështje rezulton të jetë i ulët. Në 4 prej tyre numri i të pandehurve është 1 dhe në dy të tjera është 2 dhe 3.

Vrasja dhe vjedhja konsiderohet të jenë mënyrat kryesore të veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar për kryerjen e veprimtarisë kriminale, ndërkohë që **ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve** përbën një nga veprimtaritë kryesore kriminale, të ndërmarra për kryerjen e veprave penale në fushën e krimit të organizuar.

Megjithëse numri i çështjeve në fushën e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë është më i vogël krahasimisht me çështjet në fushën e korrupsionit, në analizën e

3 – 5	persona të pandehur
5 – 10	persona të pandehur
> 10	persona të pandehur

Neni 28/4, Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale
Neni 333/a/1, Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale
Neni 333/a/2, Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal
Neni 334, Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal
Neni 334/1, Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal

Nr. i çështjes	Numri i të pandehurve	Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale
10.	1	Neni 333/a/2; Neni 334/1
11.	1	Neni 333/a/2; Neni 334/1
14.	1	Neni 333/a/2; Neni 334/1
15.	3	Neni 28/4; Neni 333/a/1; Neni 334/1
19.	1	Neni 333/a/1; Neni 334/1
20.	2	Neni 333/a/2; Neni 333/a/1; Neni 334

Tabela 2: Numri i të pandehurve në çështjet penale në fushën e krimit të organizuar, ku përfshihen vepra penale në kuadër të organizatave kriminale

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

6 çështjeve të regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021 vërehen elementë të ngjashëm me ato të analizuar në çështjet në fushën e krimit të organizuar të regjistruara gjatë vitit 2020.


Një nga mangësitë në vlerësimin e çështjeve në fushën e krimit të organizuar mbetet shtrirja transnacionale e tij si edhe dëmi i shkaktuar në ekonominë e ligjshme.

Çështje të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Janar-Mars 2021)

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës janar-mars 2021 edhe **5 çështje** të cilat lidhen me akuzat të tjera penale kundrejt subjekteve të parashikuara në kompetencë të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për 3 nga 5 çështjet e regjistruara Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka përfunduar gjykimin dhe për të 3 këto çështje Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur **moskompetencën lëndore** në lidhje me shqyrtimin e çështjeve.

Të 3 këto çështje përfshijnë akuzat për shpifje dhe fyerje ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që për 2 prej tyre Gjykata e Posaçme ka vendosur gritjen përpara Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjeve dhe për 1 prej tyre është vendosur dërgimi i akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo çfarë evidentohet në rastin e veprave penale për 5 çështjet e regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021 është numri i ulët i të



Grafik 3: Vepra të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

* (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

pandehurve si edhe akuzuesi, i cili përveçse në 1 çështje të inicuar nga Prokuroria e Posaçme, në 4 rastet e tjera është **person juridik**.

Numrin më të madh të akuzave në

këto çështje e përbëjnë veprat penale që lidhen me **shpifjen dhe fyerjen**, ndërkohë që vetëm 1 prej çështjeve përfshin akuzat për falsifikim të dokumentave dhe shpërdorimit të detyrës.

ANEKS A: Masat e dënimit të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale për korrupsionin për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallën e parë (1 Janar 2021 – 31 Mars 2021)

Nr. i çështjes	Veprat penale	Baza ligjore dhe masa e dënimit	Masa e dënimit e kërkuar nga Prokuroria	Masa e dënimit e dhënë nga Gjykata
1.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh për të pandehurin për një afat prej 24 muaj, me kusht që të mbajë kontakte me shërbimin e provës të mos kryejë asnjë vepër penale tjetër.	Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 60 orë , duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh .
3.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	Neni 244 6 muaj-3 vjet Neni 291 10 ditë-3 vjet (Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.)	Pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim prej 7 muajsh për të pandehurin për një afat 3 vjet, me kusht që të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe gjatë kohës së provës të mos kryej asnjë vepër penale tjetër.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 6 muajsh dhe vënien në provë me afat 12 muaj .
7.	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 259 2-8 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh/8 muaj dhe vënien në provë e të pandehurit për një periudhë 4 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 3 vjetësh/4 muaj dhe vënien në provë e të pandehurit për një periudhë 5 vjet .
	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet	Neni 244 6 muaj-3 vjet Neni 199/a/1 Gjobë ose burgim deri 1 vit	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh dhe vënien në provë të tij për një periudhë 4 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh dhe vënien në provë të tij për një periudhë 4 vjet .
12.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 12 mujore	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 8 mujore .
13.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	4 muaj	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 8 mujore .

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar